

VENDIM
Nr. 428, datë 11.7.2018

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURISIT
“TOKË BUJQËSORE” (ARË) NË “TOKË URBANE” (TRUALL), TË PASURIVE NR.
241/12, ME NR. KADASTRAL 237 E 238 DHE NR. 241/14, ME NR. KADASTRAL 239,
NJËSIA ADMINISTRATIVE MOLLAJ, FSHATI KAMENICË, BASHKIA KORÇË, PËR
NDËRTIMIN E OBJEKTEVE TË HIDROCENTRALIT “KAMENICË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” (arë) në “tokë urbane” (truall), të pasurive nr. 241/12, me nr. kadastral 237 e 238 dhe nr. 241/14, me nr. kadastral 239, Njësia Administrative Mollaj, fshati Kamenicë, Bashkia Korçë, për ndërtimin e objekteve të hidrocentralit “Kamenicë”.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Qarku Korçë, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimin e kategorisë të resursit, nga “tokë bujqësore” (arë) në “tokë urbane” (truall).

Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Senida Mesi